



*KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.ç.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

**PROCEDURA PËR IDENTIFIKIMIN DHE PARANDALIMIN E  
SHFRYTËZIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**21 Korrik 2009**

Duke përmbushur obligimin e përcaktuar në Nenin 29.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) ka përgatitur Procedurën për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike e cila është miratuar nga ZRRE me vendimin .V\_203\_2009 të datës 23 korrik 2009.

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj procedure është t'u mundësojë punonjësve të autorizuar të KEK-ut që me kompetencë të ndërmarrin veprime për identifikimin, inspektimin, konstatimin, parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe veprime për realizimin e kompensimit nga konsumatori për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

## **Neni 2**

### **Definicionet**

**“Abuzim i njehsorit”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

**“Inspektim”** nënkupton kontrollimin: e vendit të lidhjes, kabllit për furnizim me energji elektrike, të pikës matëse dhe pajisjet instaluese të konsumatorit.

**“Konsumator Familjar”** është çdo person fizik që përdor energjinë elektrike për konsum personal familjar, duke përjashtuar aktivitetet afariste..

**“Konsumator Jo Familjar”** është çdo person fizik ose ligjor që blenë energji elektrike jo vetëm për përdorim personal familjar, por edhe për qëllime prodhuese dhe komerciale, si dhe konsumatorët e blerjes me shumicë.

**“Kycje”** nënkupton lidhjen e objektit të konsumatorit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në bazë të kontratës së nënshkruar në mes të konsumatorit dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

**“Kycje e paautorizuar”** është një kycje në mes objektit të një konsumatori dhe një rrjeti shpërndarës të energjisë elektrike, e cila nuk është e autorizuar ose e miratuar nga ndërmarrja e energjisë.

**“Punonjës i autorizuar”** nënkupton personin që ka kontratë pune me KEK sh.a. dhe është i autorizuar për të bërë inspektimin e përdorimit të energjisë elektrike në objektet e të gjithë shfrytëzuesve të energjisë elektrike.

**“Shfrytëzimi i pakontraktuar i energjisë elektrike”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është e përcaktuar në kapitullin e 28.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

**“Shkyçja”** është ndërprerje e një lidhjeje fizike midis objektit të konsumatorit dhe një rrjeti të transmisionit apo shpërndarjes që ekzekutohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me kërkesë të Furnizuesit.

**“Vjedhje e energjisë elektrike”**: nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë procedurë do të ketë të njëjtin kuptim si termat e përdorura në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Neni 3**

#### **Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike**

Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike përfshinë këto raste, por duke mos u kufizuar në:

- a) anashkalimin e njehsorit elektrik;
- b) lidhjen direkte - pa njehsor elektrik në rrjetin e shpërndarjes;
- c) largimin e urave të tensionit;
- d) njehsorin trefazor që nuk është i lidhur sipas skemës njëpolëshe të tij;
- e) njehsorin njëfazor që nuk është i lidhur sipas skemës njëpolëshe të tij;
- f) mungesat e vulave shtetërore, vulave distributive të KEK-ut në njehsor si dhe atëherë kur këto vula janë të dëmtuara, të shoqëruara me prova faktike;
- g) dëmtimin dhe largimin i vulave të transformatorëve matës të rrymës ose të tensionit te grupet matëse, të shoqëruara me prova faktike;
- h) dëmtimin apo largimi i përcuesve të lidhjeve të grupeve matëse;
- i) dëmtimin fizik i shtëpizës, xhamit të njehsorit, hapja e vrimës në shtëpizë, frenimi i diskut, dëmtimi i numërorit, etj;
- j) izolimin e urave të tensionit të njehsorit me ndonjë material izolues;
- k) shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pakontraktuar (neni 28.1 të Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit) si p.sh. dhënia e energjisë elektrike ndonjë konsumatori tjetër pa autorizimin e KEK-ut.

### **Neni 4**

#### **Lajmërimi i dyshimit të shfrytëzimit të paautorizuar**

- 4.1 Lajmërimi i dyshimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike mund të bëhet nga punonjësit e KEK-ut apo nëpërmjet informatave të siguruar nga komuniteti.

- 4.2 Me rastin e marrjes së informatave për dyshimin e shfrytëzimit të paautorizuar sikurse në nenin 4.1, KEK-u do të ndërmarrë masat e menjëhershme operative, duke dërguar punonjësit e autorizuar në lokacionin e dyshuar për shfrytëzim të paautorizuar, me qëllim të verifikimit dhe raportimit të rastit.
- 4.3 Punonjësit e autorizuar të KEK-ut kur kryejnë punë zyrtare obligohen ta mbajnë me vete në vend të dukshëm kartelën zyrtare.
- 4.4 Parregullsitë sipas nenit 3 që mund të vërehen lehtë gjatë kryerjes së punëve të tyre të rregullta, e që nuk raportohen nga zyrtarët e KEK-ut, konsiderohen shkelje të detyrave të punës konform aktit normativ të KEK-ut.

## **Neni 5**

### **Të drejtat e punonjësve të autorizuar**

- 5.1 Punonjësit e autorizuar për inspektim të shfrytëzimit të energjisë elektrike në objektin e konsumatorit kanë të drejtëtë:
  - a) hyjnë në objektet e banimit në prani dhe me pëlqim të konsumatorit, për të inspektuar mënyrën e furnizimit me energji elektrike nga pika matëse deri te pajisjet e energjisë elektrike konform dispozitës së nenit 19.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
  - b) hyjnë në çdo kohë në ndërmarrje, institucione, lokale ose vende tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë personat juridik për të inspektuar shfrytëzimin e energjisë elektrike përkatësisht instalimin dhe sistemin matës;
  - c) shkyçin objektin e konsumatorit nga furnizimi me energji elektrike për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar, shkyçja mund të bëhet në çdo kohë nga së paku dy punëtorë të autorizuar të KEK-ut.
- 5.2 Në rast se konsumatori refuzon të lejojë qasjen në pronën apo në objektin e tij punonjësve të autorizuar të KEK sh.a. për të inspektuar mënyrën e furnizimit me energji elektrike nga pika matëse deri te pajisjet e energjisë elektrike, atëherë mund të kërkohet asistencë nga organet e sigurisë për të kryer veprimin e planifikuar konform nenit 22.3 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

## **Neni 6**

### **Urdhëresa e punës**

- 6.1 Kur paraqiten rastet sipas nenit 4.2 të kësaj Procedure, Udhëheqësi i Sektorit për mbrojtjen e të ardhurave në distrikte, jep urdhëresën e punës me shkrim punonjësve të autorizuar të inspektimit.
- 6.2 Me urdhëresë verbale mund të veprohet vetëm në rastet kur:

- a) Drejtori i OSSH-së ose Drejtori i Departamentit për mbrojtjen e te ardhurave kërkon që punonjësit e autorizuar të inspektimit të veprojnë në bazë të urdhëresës verbale të tij/saj;
  - b) punonjësit e autorizuar gjatë orëve të punëve identifikojnë çfarëdo shfrytëzimi të paautorizuar të energjisë elektrike dhe nuk është e mundur të marrin urdhëresë me shkrim;
  - c) aktiviteti i vërejtur paraqet rrezik për rrjetin elektrik dhe që kërkon intervenim të menjëhershëm.
- 6.3 Pas kryerjes së punës sipas rasteve si nën 6.2 a), b) dhe c), përgjegjësi i punonjësve të autorizuar plotëson urdhëresën e punës e cila i dorëzohet personit përgjegjës për aprovim dhe nënshkrim.
- 6.4 Punonjësit e autorizuar të KEK-ut gjatë inspektimit do t'i përmbahen Kodit të Etikës, përshkrimin të vendit të punës, procedurave të punës dhe udhëzimeve në urdhëresë të lëshuar nga udhëheqësi i tij/saj duke u prezantuar dhe sqaruar qëllimin e vizitës te konsumatori.

## **Neni 7**

### **Inspektimi i shfrytëzimit të energjisë elektrike**

- 7.1 Inspektimi i shfrytëzimit të energjisë elektrike përfshin këto raste, por duke mos u kufizuar në:
- a) inspektimin e tërësishëm të instalimit elektrik në objektin e konsumatorit, me qëllim të konstatimit të çfarëdo anashkalimi të njehsorit;
  - b) inspektimin e mënyrës së lidhjes së njehsorit në rrjet.

## **Neni 8**

### **Pasaktësia në matje dhe verifikimi i njehsorëve elektrikë**

- 8.1 Në rastet kur punonjësit e autorizuar dyshojnë se njehsori elektrik nuk është duke regjistruar me saktësi të lejuar shfrytëzimin e energjisë elektrike, atëherë njehsori elektrik mund të dërgohet për verifikim në laboratorin të kalibrimit.
- 8.2 Mënyra e verifikimit të njehsorit nga laboratorin e kalibrimit është përcaktuar në udhëzimet administrative të lëshuara nga MTI-ja dhe kodi i matjes.
- 8.3 Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.
- 8.4 Procesverbali i plotësuar me konstatimet teknike nga punonjësit e laboratorit të kalibrimit të përcaktuara në paragrafin 8.3 dërgohet te komisioni i cili do të jetë i përbërë prej së paku tre antarëve: një nga OSSH-ja, kurse dy nga Furnizuesi. Veprimet të cilat do t'i ndërmerren ky komision janë:

- a) analizon procesverbalin e ekipit të inspektimit i cili ka hequr njehsorin dhe procesverbalin e shërbimit të verifikimit dhe kalibrimit;
- b) analizon historikun e vendosjes së njehsorit, blerjen, montimin, inspektimin, listat e leximit etj;
- c) analizon profilin e konsumatorit, konsumin, pagesat;
- d) përgatit një raport në lidhje me këtë njehsor dhe në bashkëpunim me zyrën ligjore, nëse vlerëson se konsumatori ka abuzuar njehsorin me qëllim për të vjedhur energji, procedon lëndën e kompletuar te sektori i faturimit për të përgatitur faturën për rikthimin e energjisë së humbur.

## **Neni 9**

### **Veprimet pas konstatimit të shfrytëzimit të paautorizuar**

- 9.1 Veprimet që ndërmerren me rastin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të pa kontraktuar sipas nenit 3 pika (k) të kësaj procedure janë:
- a) shkyç objektin e konsumatorit nga rrjeti shpërndarës pas njoftimit paraprak të konsumatorit;
  - b) plotëson procesverbalin dhe dorëzon një kopje konsumatorit, procesverbali përmban edhe udhëzimin për mundësin e ankesës brenda afatit katërmëdhjetë (14) ditësh si dhe udhëzimin për të lidhur kontratën për shfrytëzim të energjisë elektrike me KEK sh.a;
  - c) shkyçë konsumatorin e rikyçur arbitrarisht me mundësi të heqjes së pajisjeve për furnizim me energji elektrike konform nenit 26 të Rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.
- 9.2 Nëse gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ekipi për inspektimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike has në shfrytëzues të energjisë elektrike duke shfrytëzuar energji sipas pikave (a, b, c, d dhe e) të nenit 3 të kësaj procedure atëherë ekipi obligohet të kryejë veprimet e mëposhtme:
- a) përpilon procesverbalin në të cilin përshkruhet shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike;
  - b) bënë fotografimin e vendit që tregon mënyrën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike sipas fakteve të shkruara në procesverbal;
  - c) bënë regjistrimin e të gjitha pajisjeve elektrike të instaluara që disponon konsumatori, të dhënat teknike të pikës matëse, kablllove furnizuese, siguresave kryesore, numrin dhe gjendjen e numëruesit të njehsorit;
  - d) harton procesverbalin në katër (4) kopje: një kopje e mbajnë punonjësit e autorizuar të inspektimit, një kopje i dorëzohet-i/lihet konsumatorit kurse nga një kopje u dërgohet

Departamentit për faturim dhe Departamentit për konsumatorë. Procesverbali do të hartohet në gjuhën shqipe. Në rast të kërkesës së konsumatorit, KEK-u do të sigurojë procesverbalin edhe në një nga gjuhët zyrtare të kërkuar nga konsumatori.

- 9.3 Ekipi për inspektim kur has në shfrytëzues të energjisë elektrike duke abuzuar me njehsor elektrik sipas pikës (f, g, h, i dhe j) të nenit 3 të kësaj procedure, obligohet të kryejë veprimet e mëposhtme:
- a) shkyç furnizimin me energji elektrike, largon njehsorin elektrik në të cilin janë konstatuar gjurmë të abuzimit dhe të njëjtin e dërgon në laboratorin e kalibrimit;
  - b) regjistron të gjitha pajisjet elektrike të instaluara që disponon konsumatori, regjistron të dhënat teknike të pikës matëse, kabllove furnizuese, siguresave kryesore, numrin dhe gjendjen e numëruesit të njehsorit, dhe një kopje të këtij procesverbali ia dorëzon konsumatorit;
  - c) vendos tjetër njehsor në afatin jo më vonë se 24 orë nga koha e largimit të njehsorit sipas pikës (a), në objektin në të cilin është ndërprerë furnizimi me energji elektrike.

## **Neni 10**

### **Forma e procesverbalit**

- 10.1 Me rastin e inspektimit punonjësit e autorizuar të KEK-ut do të kompletojnë formën standarde të raportimit. Kopja e formës raportuese paraqitet në Shtojcën 2 të kësaj procedure.
- 10.2 Procesverbali duhet të kompletohet te vendi i ndodhjes së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe në prezencën e shfrytëzuesit të energjisë elektrike ose të ndonjë anëtarit të familjes së shfrytëzuesit të moshës madhore, përveç në rrethanat e pengimit (p.sh. në rastet e kërcënimit).

Procesverbali duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) datën e përpilimit dhe numrin rendor të procesverbalit;
- b) për konsumatorët familjarë emrin, emrin e babës, mbiemrin, shifrën e konsumatorit, adresën e vendbanimit, numrin personal, datën e lindjes, vendin e lindjes, komuna;  
  
Për konsumatorët jo-familjarë emrin e biznesit, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të autorizuar të konsumatorit jo-familjarë, numrin personal të tij, adresën e lokacionit, llojin e biznesit, numrin e regjistrimit të biznesit, grupin tarifor dhe shifrën e konsumatorit;
- c) përshkrimin e qartë, të saktë dhe të kompletuar të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike;
- d) përshkrimin e veprimeve të ndërmarra pas konstatimit për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike: evidentimi i saktë i të gjitha pajisjeve elektrike që posedon konsumatori në momentin e plotësimit të procesverbalit, shkyçja nga rrjeti, riaftësimi i pikës matëse etj;

e) nënshkrimin e shfrytëzuesit të paautorizuar të energjisë elektrike;

Refuzimi eventual për tu nënshkruar do të shënohet në procesverbal;

f) përshkrimin detal në rast të kërcënimit, pengimit apo dhunës eventuale ndaj punonjësve të autorizuar , së bashku me çfarëdo të dhënash personale të cilat mund të merren nga personi (personat) që ushtrojnë kërcënimin, pengimin apo dhunën.

## **Neni 11**

### **Marrja e fotografive (dëshmime)**

Punonjësit e autorizuar të KEK-ut duhet të bëjnë fotografi nga vendi i ndodhjes së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe prova tjera që i bashkëngjiten procesverbalit. Fotografitë duhet të:

- a) paraqesin informatat të cilat identifikojnë vendin e ndodhjes (p.sh. objekti, numri i ndërtesës dhe emri i rrugës);
- b) paraqesin orarin e punës te konsumatorët komercial, nëse ka;
- c) jenë të qarta dhe të lexueshme;
- d) paraqesin mënyrat e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike;
- e) paraqesin numrin e njehsorit, gjendjet faktike të numërorit dhe tiketën që tregon datën e vulosjes, etj.

## **Neni 12**

### **Verifikimi i procesverbaleve nga zyra ligjore**

12.1 Procesverbal i përgatitur sipas Nenit 10 të kësaj procedure dhe dëshmitë tjera të marra nga vendi i ndodhjes, do të dorëzohet me letër përcjellëse në Zyrën Ligjore të KEK-ut për të përcaktuar nëse ka bazë ligjore për ushtrim të Kallëzimit penal për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Pas përpunimit të çdo rasti, Zyra Ligjore i përcjell procesverbalin Departamentit të Faturimit për veprime të mëtejme.

12.2 Nëse Zyra Ligjore konstaton se procesverbal i nuk është i kompletuar, ka ndonjë paqartësi (mangësi), ai duhet të kthehet te Udhëheqësi i punonjësve të autorizuar për korrigjim dhe kompletim adekuat. Për kompletim të procesverbalit duhet të bëhet ekzaminimi shtesë, atëherë duhet të zbatohen procedurat e njëjta si gjatë inspektimit të parë. Pas kësaj ndiqet procedura sipas nenit 12.1.

## **Neni 13**

### **Llogaritja dhe faturimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike**

13.1 Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike sipas 9.2 dhe 9.3 të kësaj procedure nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët familjar do të merret që



shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj, ndërkaq për konsumatorët tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur konsumatori është zbuluar, ose nga data e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull.

- 13.2 Nga sasia e energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar e përcaktuar nga Departamenti i Faturimit duhet të zbritet sasia e energjisë elektrike që është faturuar/regjistruar në njehsor gjatë asaj periudhe.
- 13.3 Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është identifikuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike. Për konsumatorët familjare do të zbatohen tarifat e grupit një tarifor të ndara në mënyrë proporcionale sipas sezoneve (verë–dimër), kurse për konsumatorët komercial do të zbatohet tarifa e larte, gjithashtu të ndarë sipas sezoneve.

#### **Neni 14**

##### **Llogaritja dhe faturimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për Konsumatorët Familjar**

- 14.1 Llogaritja e shpenzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për konsumatorët familjare bazohet në pajisjet që konsumatori disponon në momentin e kontrollimit.
- 14.2 Llogaritja e shpenzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për konsumatorët familjare bëhet duke regjistruar fuqinë e secilës pajisje që gjendet te konsumatori gjatë inspektimit duke shumëzuar me kohën e shfrytëzimit mujor (orë/muaj).
- 14.3 Numri i orëve të punës për pajisjet shtëpiake për një ditë:

Pajisjet për zierje të ushqimit shporeti, furra etj	1.5 orë
Pajisjet për ftohje, frigoriferi etj	8 orë
Makinat për larje, lavatriçja, enëlarësja etj	1 orë
Pajisjet për ngrohje të ujit, bojlerët, etj	3 orë
Pajisjet për kafe dhe çaj	1 orë
Pajisjet për ndriçim, poçet, etj	5 orë
Pajisjet për hekurosje	1 orë
Pajisjet elektronike, TV, radio, kompjuteri etj	6 orë
Pajisjet për ngrohje/ftohje	8 orë
Vegla për punë shtëpiake	1 orë

- 14.4 Për shfrytëzuesit e energjisë elektrike të cilët nuk e kanë statusin e konsumatorit të KEK sh.a dhe kyçen në rrjetin e shpërndarjes pa pajisje matëse, llogaritja do të bëhet sipas dispozitave të kësaj procedure.
- 14.5 Në rastet kur ekipeve të autorizuara nuk ju lejohet qasja në objektet e banimit (shtëpi, banesë) për sigurimin e shënimeve të pajisjeve elektrike të instaluara, KEK-u do të aplikojë llogaritjen e shpenzimit të paautorizuar në mënyrë paushalli për muaj 1,100 kWh për konsumatorët shtëpiak dhe 750 kWh për konsumatorët në banesa.

### **Neni 15**

#### **Llogaritja dhe faturimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për Konsumatorët Jo - Familjar**

- 15.1 Llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të konsumatorët jofamiljarë bëhet sipas pajisjeve që konsumatori disponon në momentin e inspektimit.
- 15.2 Llogaritja e fuqisë maksimale do të definohet si:

Shuma e fuqisë së shpenzuesit më të madh ( $P_1$ ) të regjistruar, plus  $2/3$  e fuqisë së shpenzuesit të dytë me fuqi më të madhe ( $P_2$ ) të regjistruar, plus  $1/3$  e tërës fuqisë së shpenzuesve të tjerë ( $P_n$ ), e paraqitur si në shprehjen e mëposhtme:

$$P_{\max} = P_1 + \frac{2}{3} \times P_2 + \frac{1}{3} \sum_3^n P_n$$

- 15.3 Llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për një muaj bëhet nga caktimi i vlerës së fuqisë sipas nenit 15.2 shumëzuar me numrin e orëve:

- 176 orë pune për një ndërrim (8-orë)
- 264 orë pune për dy ndërrime jo të plota apo një ndërrim i zgjatur (12-orë)
- 352 orë pune për dy ndërrime të plota (2x8-orë) dhe
- 528 orë pune për tri ndërrime (3x8orë)

Orari i punës do të definohet sipas lejes së punës së lëshuar nga Komuna. Orari i punës duhet të jetë i reklamuar në vend të dukshëm nga vet konsumatori ose në bazë të veprimtarisë së ushtruar.

- 15.4 Në rastet kur ekipeve të autorizuara të KEK-ut nuk iu lejohet qasje në objektin komercial për evidentimin e pajisjeve elektrike të instaluara, atëherë KEK-u do të përcaktoj fuqinë e angazhuar në bazë të pëlqimit elektroenergjetik.
- 15.5 Përveç llogaritjes së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të përcaktuara në nenin 16 dhe 15, konsumatori mundë të ngarkohet edhe me shërbime tjera si: shkyçja, rikyçja, gjobat, rregullimi i njehsorit elektrik dhe angazhimi i palës së tretë.

## **Neni 16**

### **Dorëzimi i Faturës**

Faturën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, Furnizuesi obligohet t'ia dërgojë konsumatorit në afatin sa më të shkurtër, e më së largu deri në tetë (8) ditë kalendarike pas përpilimit të procesverbalit.

## **Neni 17**

### **Ankesat e konsumatorëve**


- 17.1 Konsumatori ka të drejtë që ta kundërshtojë faturën e rikthimit të energjisë së humbur, në afat prej katërmëdhjetë (14) ditësh kalendarike pas marrjes së faturës nga Furnizuesi.
- 17.2 Ankesat e konsumatorëve do t'i shqyrtojë një panel i brendshëm i përbërë prej tre anëtarëve: një anëtar do të jetë nga zyra ligjore, një nga shërbimi i faturimit dhe një nga shërbimi i kujdesit ndaj konsumatorit
- 17.3 Paneli do të shqyrtojë ankesat e konsumatorëve në përputhje me Rregullën mbi procedurën për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë dhe procedurave të brendshme të KEK sh.a
- 17.4 Afati i dhënies së përgjigjes nga Furnizuesi në ankesën e konsumatorit nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarikë prej datës së regjistrimit të ankesës së konsumatorit.
- 17.5 Furnizuesi duhet të posedojë dëshmi që konsumatori e ka marrë përgjigjen në ankesë.
- 17.6 Përgjigja duhet të përmbajë udhëzimin për konsumatorin mbi të drejtën e tij për të paraqitur apel te ZRRE, në afatin prej 14 ditësh kalendarikë, kundër përgjigjes së dhënë nga KEK-u, konform nenit 9.3. shkronjës (e) dhe nenit 13.1 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë”.
- 17.7 KEK-u mund të mos fillojë procedurë gjyqësore përderisa kontesti civil është në proces në ZRRE, duke përfshirë raste kur palët për zgjidhjen e kontesteve kanë përdorur Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ZAK), sipas nenit 20 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

## **Neni 18**

### **Hyrja në fuqi**

- 18.1 Kjo Procedurë hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
- 18.2 Kjo Procedurë mund të ndryshohet, kohë pas kohe, me kërkesën e KEK sh.a. dhe me aprovim nga ZRRE-ja

Shtojca 1, Forma e procesverbalit të punonjësve të autorizuar



SHËNIM: KEK-UT ËSHTË NËN DREKTORATIN E KËRKIMIT DHE  
 DEZAVOLGIMIT TË PËRVEKTRIKËS SË SHQIPËS  
 PËR SHËRIMIN E SHËNËSËSË

Distrikt: \_\_\_\_\_

Shifra e konsumatorit: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL Nr. 000001**

I përpluar të Konsumatori (Emri, Emri Babës, Mbiemri): \_\_\_\_\_

Adresa-vendbanimi \_\_\_\_\_ Nr. personali \_\_\_\_\_

I lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ KK \_\_\_\_\_

Emërtimi i veprimtarisë komerciale (Biznesit): \_\_\_\_\_

Nr. i biznesit: \_\_\_\_\_ Adresa e biznesit: \_\_\_\_\_

**Gjendja e njësorit:**

Gjendja : Tarifa e I-rë \_\_\_\_\_

Tarifa e II-të \_\_\_\_\_

Tipi i njësorit: \_\_\_\_\_

Numri i njësorit \_\_\_\_\_

Numri i Plombës \_\_\_\_\_

---

Punorët e autorizuar të KEK-ut, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të konsumatori - shfrytëzues i energjisë elektrike, kanë konstatuar në vendin e ngjarjes këtë gjendje: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Nr. Rend	Lloji-Tipi- i aparatit shpenzues	Copë	Fuqia W	Nr. Rend	Lloji-Tipi- i aparatit shpenzues	Copë	Fuqia W
1				6			
2				7			
3				8			
4				9			
5				10			

Gjendja e njësorit pas konstatimit: ( i kyçur \_\_\_\_\_ / i shkyqur \_\_\_\_\_ ) Nr. i Plombës \_\_\_\_\_

**Njoftim- Vrejtje për konsumatorin:**  
 Në bazë të kësaj, ju si konsumatorë jeni të obliguar që menjëherë (në të voni brenda 8 ditë) të paraqiteni në KEK, sh.a. Distrikti \_\_\_\_\_ Departamenti për Konsumatorë në \_\_\_\_\_ zyra nr. \_\_\_\_\_ kati \_\_\_\_\_ që të merreni veshime të përkatëse, ndihur me kalkulimin e obligimit financiar.  
 Sipas gjendjes të konstatuar më lartë është evidente se kemi kryer veprim të kundërligjshëm (të caktuar rastit - vjedhje, demtim apo ....), me që rast janë përfshirë hushorët për blimin e procedurës për ndjekje penale.

**Konsumatori**

Emri, Mbiemri dhe Nënshtkrimi,

\_\_\_\_\_

**Personi i autorizuar:**

Nënshtkrimi dhe Numri Punës

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

Vendosja e shifrës Procesverbali është e obligueshme dhe duhet të bëhet në 2 (dy) kopje të përbashkëta.      Revizori: July 11, 2007